



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-lizazna

Nr. 1-84
Br.

Data 22.05.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës, nenit 11 dhe nenit 3.9, të Rregullores së punës të Kuvendit, si dhe referencës nr.ZSP-1039/13, nr.prot.3890/13, të dt. 23.10.2013, nga sekretari i përgjithshëm MMPH, të mbështetur në Kornizën e Politikave të Zhvendosjes për zonën Mihja e Re e hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe miratuar me vendim nr.10/22, të dt.06.07.2011, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr. V-456, të dt.15.05.2018, në mbledhjen e mbajtur me dt. 22.05.2018, mori këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi nr.I-95, i dt.30.10.2013, për lirim nga taksat administrative për banorët e zhvendosur të lagjes Shala-Fshatit Hade.
2. Lirohen nga taksat administrative komunale banorët e Hades, Shipitullë dhe Caravodicë, që kanë të bëjnë me bartjen e pronës, të cilët janë në procedurë të zhvendosjes sipas aktvendimeve individuale të nxjerrura nga MMPH, për secilin pronar që ka fituar të drejtën për truall në lokacionin Hade e Re - Shkabaj, e drejtë kjo e fituar në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara dhe përcaktimit për formën e kompenzimit nga ana e pronarëve.
3. Lirohen nga taksat administrative për kushte ndërtimore, leje ndërtimore, bartje prone, fleta poseduese, kopje plani, për ndërtimin e shtëpive individuale në këtë lokacion (Hade e Re – Shkabaj) për pronarët të cilët kanë poseduar objekte banimi në fshatrat Hade, Shipitullë dhe Caravodicë, si opsion i zëvendësimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- Drejtorit të ad.së përgj.
- Këshilltarëve
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit

Kryesues i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri





Dok. nr. / Data

Dr. V-456 Data 15.05.2018

Br.


Datum

REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria -Vlada -Government



Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër

Data :	15.05.2018
Për:	Kuvendin Komunal-Obiliq
Nga:	z.Arben Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Pronë 
Lënda:	Kërkesë

Kërkojmë nga Kuvendi Komunal në Obiliq që të shqyrtoj kërkesën tonë dhe të bëjë plotësim ndryshimin e Vendimit nr.1-95 të dt.30.10.2013 për lirim nga taksat administrative për banorët e zhvendosur të lagjes Shala-Fshatit Hade.

Në kuadër të këtij Vendimi të parashihet lrimi nga taksat administrative komunale (kërkesat për fletë poseduese, kopje plani, bartje pronës, kërkesa për kushtet ndërtimore, kërkesa për leje ndërtimore, si dhe pagesa e lejes ndërtimore) edhe për banorët e fshatit Shipitullë, Hade dhe Caravodicë të cilët janë në proces të Shpronësimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
DIREKTORIA E ARVIASTRITËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË
OPSTINA OBILIC - KOSOVO
MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

KUVENDI

Qelbivartaria

Nr. 1-35

Data 30.10.2013

Nr.

Data

OBJEKTI/OBJEKT:

Në bazë të nenit 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-40, Statutit të Komunës nr.01-51-10 të dt.10.03.2010 si dhe references nr.ZSP-1039/13 ,nr.prot.3890/13 të dt.23/10/2013,nga Sekretari Përgjithshëm në MMPH të mbështetur në Kornizën e politikave të Zhvendosjes për zonën Mihja e Re e hartuar në Bashkëpunim me Bankën Botërore dhe të miratuar me Vendimin nr.10/22 të dt.06.07.2011 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Komunës së Obiliqit ,në mbledhjen e mbajtur më 30/10/2013,miratoi këtë:

VENDIM

PËR LIRIMIN NGA TAKSAT ADMINISTRATIVE PËR BANORËT E ZHVENDOSUR TË LAGJES SHALA -FSHATI HADE

I. Lirohen nga taksat administrative komunale banorët e lagjes Shala nga Fshati Hade , që kanë të bëjnë me bartje të pronës, të cilët janë në procedure të zhvendosjes sipas Aktvendimeve individuale të nxjerrur nga MMPH për secilin pronar që ka fituar të drejtën për Truall në lokacionin Hade e Re-Shkabaj,e drejtë kjo e fituar në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara dhe përcaktimit për formën e kompenzimit nga ana e pronarëve.

II. Lirohen nga taksat administrative për Kushtet Urbanistike dhe Leje Ndërtimore për ndërtimin e shtëpive individuale në këtë lokacion,për pronarët të cilët kanë poseduar object banimi në fshatin Hade,si option i zëvendësimit.

III.Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. _____,

Obiliq

Dt. 30.10.2013

